

FJALA E GUVERNATORIT

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë, i përcaktuar në programin e saj për vitin 2001, ishte arritja e normës vjetore të inflacionit brenda intervalit 2-4 për qind. Ky objektivi u arrit të realizohej. Norma vjetore e inflacionit për fundin e vitit 2001 arriti në 3.5 për qind.

Megjithatë, në zhvillimet gjatë vitit 2001, sidomos në gjashtëmujorin e dytë të tij, u vërejtën fenomene kontradiktore, të cilat rritën shkallën e vështirësisë për arritjen e objektivave. Gjatë kësaj periudhe kemi ndikimin e ngjarjeve të tilla si: kriza energjitike, e cila erdhi duke u përkeqësuar dhe u shoqërua, ndër të tjera, edhe me pezullim të disa aktiviteteve të subjekteve private; kriza politike, e cila rriti shkallën e pasigurisë për zhvillimet ekonomike; moti i keq, që kërkoi energji dhe fonde për të administruar problemet që u krijuan; rritja e çmimit të energjisë elektrike dhe deklaratimet për rritje të çmimeve të tjera si të ujit të pijshëm, të shërbimit telefonik apo e kontributeve të sigurimeve shoqërore për disa kategori si dhe e pagesave të tatimeve fikse; “qetësimi” i shpenzimeve buxhetore dhe ecuri më e harmonizuar e tyre deri në fund të vitit, duke reduktuar përqendrimin e shpenzimeve të tilla në fund të vitit, fenomen i vërejtur historikisht; ngadalësimi i përgjithshëm i rritjes së ekonomisë botërore dhe rritja e pasigurisë, element që konsiderohet më i dëmshëm për zhvillimin ekonomik sesa rritja e shkallës së rrezikut; prezantimi fizik i euros më 1 janar të vitit 2002, gjë që kërkoi një proces përgatitor, i cili u intensifikua në gjysmën e dytë të vitit 2001 si dhe krijoi zhvillime të ndryshme nga fenomenet e vërejtura historikisht në kursin e këmbimit të lekut kundrejt monedhave të tjera; konflikti në FYROM, efektet e të cilit u ndjenë të paktën edhe në tremujorin e tretë të vitit 2001 si dhe kriza financiare në Turqi.

Zhvillimet në çmimet e konsumit vërtetuan që kemi hyrë në një fazë me inflacion pozitiv pas periudhës, relativisht të gjatë, të deflacionit të përjetuar në vitin 1999 dhe gjysmën e parë të vitit 2000. Inflacioni mesatar për vitin 2001 ishte në nivelin 3.1 për qind kundrejt nivelit 0 të një viti më parë. Inflacioni bazë, në fund të vitit 2001, arriti në 1.08 për qind. Edhe kjo kategori inflacioni paraqet si tendencë rritjen e tij. Në tërësi, rritja e treguesit të inflacionit u ndikua kryesisht nga krahu i ofertës, por pati presione edhe nga krahu i kërkesës (rritja e ofertës monetare si dhe e kredisë për ekonominë mbi parashikimin). Po kështu, përsëritja e faktorëve nga krahu i ofertës, njëri pas tjetrit, krijoi një presion të vazhdueshëm inflacionist.

Në përgjigje të rritjes së presioneve inflacioniste në pjesën e parë të vitit si dhe të rënies së vazhdueshme të normave të interesit, Banka e Shqipërisë kreu një ndryshim të politikës monetare duke ndryshuar tipin e ankandit të marrëveshjeve të riblerjes. Synimi i këtij ndryshimi ishte sinjalizimi i një politike monetare neutrale ndaj normave të interesit, duke shënuar fundin e një periudhe gjatë së cilës politika monetare ka synuar uljen e vazhdueshme të tyre.

Megjithatë, ky qëndrim rezultoi i pamjaftueshëm. Prandaj, ishte e nevojshme një ndërhyrje e Bankës së Shqipërisë dhe përcjellja e një mesazhi më të fortë në treg në drejtim të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve duke rritur normën e interesit bazë. Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë, synonte, veçanërisht në ndryshimin e tendencës rritëse të pritjeve inflacioniste në ekonomi dhe në ndalimin e rënies së normave të interesit në tregjet financiare. Ky vendim merrej pas gati tre vjetësh gjatë të cilëve politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka synuar reduktimin e normave të interesit në ekonomi.

Të gjitha këto qëndrime përçuan në treg sinjalin, që niveli i arritur i interesave për këtë periudhë ishte optimal dhe nuk duhej të ushtrohej më presion për reduktimin e mëtejshëm të tyre.

Ecuria dhe pritshmëritë e inflacionit në muajt vijues nuk kanë paraqitur të nevojshëm një ndryshim të normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.

Në fund të vitit 2001, rritja e ofertës monetare rezultoi 19.9 për qind nga 15.4 për qind që ishte parashikuar në program. Megjithë ndikimet në inflacion, rritja e ofertës monetare vlerësohet se nuk qe e tillë që të shkaktonte mosrespektim të objektivit për inflacionin. Kjo rritje pasqyron kërkesën e ekonomisë për mjete monetare si edhe rritjen e depozitave në valutë gjatë gjashtëmujorit të dytë. Kredia për ekonominë i tejkaloi parashikimet e Bankës së Shqipërisë me rreth 4 miliardë lekë, duke shfaqur përqendrim sidomos në muajin e fundit të vitit. Po ashtu, depozitat në valutë shënuan rritjen më të lartë të tyre gjatë dy viteve të fundit, kryesisht si pasojë e prezantimit të monedhës së përbashkët europiane në tregun valutor.

Banka e Shqipërisë ka arritur të realizojë tre objektivat sasiorë të saj. Rezervat ndërkombëtare neto ishin 61 milionë dollarë amerikanë mbi kufirin e poshtëm të tyre. Mjetet e brendshme neto rezultuan 2 miliardë lekë nën kufirin e sipërm të tyre. Pretendimet neto ndaj Qeverisë qëndruan rreth 1.6 miliardë lekë nën kufirin e sipërm. Këto të fundit, nuk shfaqën devijime nga tendenca e tyre rritëse në çdo fundviti. Megjithatë duhet theksuar se Qeveria siguroi respektimin e objektivave sasiorë për financimin e deficitit, sidomos atij të financiar me burime të brendshme.

Shkëlqim Cani
Guvernator

1. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE

1.1. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E JASHTME

Ekonomia botërore, e cila nisi të shfaqte shenja ngadalësimi që në tremujorin e dytë të vitit 2001, u ballafaqua me një provë të vështirë në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Goditja që pësuan SHBA në shtator, përveç përhapjes së frikës nga terrorizmi, rezultoi në fillimin e luftës ndaj këtij të fundit. Ndërkohë që në botë bëheshin përpjekje për tejkalimin e krizës apo të ngadalësimit ekonomik, Shqipëria përjetonte edhe probleme të brendshme siç ishin kriza e thelluar energjitike dhe kriza politike.

Ngadalësimi ekonomik që filloi në Zonën e Euros gjatë tremujorit të dytë të vitit 2001, vazhdoi të vihej re edhe në gjashtëmujorin e dytë të vitit. Rritja ekonomike vjetore për tremujorin e tretë ka qenë 1.4 për qind, ndërkohë që parashikimi për tremujorin e katërt është 0.9 për qind. Prodhimi industrial për zonën e Bashkimit Monetar Europian ka rënë me 0.5 për qind gjatë kësaj periudhe. Papunësia për Zonën e Euros luhetet në kufijtë 8.4-8.5 për qind duke u ndikuar, gjithashtu, nga zhvillimet në vendet e lartpërmendura. Inflacioni vjetor i zonës në shqyrtim arriti në nivelin 2 për qind në muajin nëntor nga 2.8 për qind në korrik. Rritja ekonomike për dy tremujorët e parë të vitit 2002 pritet të jetë 1.3 dhe 1.8 për qind.¹

Tabelë 1: Ecuria e PBB-së dhe IÇK-së për disa ekonomi² (në përqindje).


	Ndryshimi i PBB			Ndryshimi i IÇK		
	2000	2001	2002	2000	2001	2002
SHBA	4.1	1.0	0.7	3.4	2.9	1.6
Japonia	2.2	-0.4	-1.0	-0.8	-0.7	-1.0
Eurozona	3.4	1.5	1.2	2.4	2.7	1.4
Gjermania	3.0	0.5	0.7	2.1	2.4	1.0
Franca	3.5	2.1	1.3	1.8	1.8	1.1
Britania Madhe	2.9	2.3	1.8	2.1	2.3	2.4

Gjatë vitit 2001, edhe ekonomia e SHBA përjetoi recesionin më të thellë të dhjetëvjeçarit të fundit. Shifra e korigjuar e rritjes së PBB-së për tremujorin e tretë ishte -1.1 për qind. Ngadalësimi filloi në muajin mars, pasi ekonomia arriti majën e saj më të lartë. Pas goditjes fatale në muajin shtator, treguesit e prodhimit, të besimit të biznesit etj., të cilët nuk kishin qenë shumë të lartë as më parë, filluan të përkeqësoheshin me shpejtësi. Ekonomia u mbështet në prirjen e konsumatorëve për të shpenzuar. Megjithë ndërhyrjen për të lehtësuar barrën fiskale dhe veprimet e Rezervës Federale për të nxitur investimet, rimëkëmbja e ekonomisë në vitin 2002 shihet ende me skepticizëm.

¹ Burimi: Euro – Frame Forecast- <http://www.euro-frame.org/forecast/report>.

² Burimi: Fondi Monetar Ndërkombëtar: World Economic Outlook, Dhjetor 2001.

Grafik 1: Norma politike e Bankës Qendrore Europiane dhe Rezervës Federale (viti 2001).³



1.1.1 Ekonomitë e rajonit gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit⁴

Ekonomia e FYROM-it ka vazhduar të vuajë pasojat e konfliktit të armatosur që shpërtheu në gjysmën e parë të vitit. Viti 2001 pritet të rezultojë në një rënie prej 4.5 për qind të PBB-së dhe rritje të çmimeve të konsumit me rreth 5.3 për qind.

Të dhënat nga ekonomia jugosllave sugjerojnë se vendi, gjatë vitit 2001, ka patur një rritje pothuaj të njëjtë me atë të një viti më parë (5.5 për qind). Inflacioni parashikohet të zbrësë në nivelin 40 për qind nga 113.5 që ishte në fund të vitit 2000, ndërkohë që deficitit i llogarisë korente dhe ai buxhetor janë më të ulët se një vit më parë.

Ekonomia e Greqisë u rrit me 4.4 për qind gjatë tremujorit të tretë duke manifestuar kështu shenja ngadalësimi pas një fillimi pozitiv të vitit. Inflacioni vjetor në muajin dhjetor ishte në nivelin 3.5 për qind.

Turqia u përfshi nga kriza financiare si rezultat i së cilës, në fund të vitit 2001, falimentuan pesë banka të mëdha. Parashikimi i Qeverisë Turke për rritjen ekonomike të vendit gjatë vitit 2001 është -8.5 për qind ose e thënë ndryshe parashikohet rënia më e madhe që nga viti 1945.

³ Burimi: Banka Qendrore Europiane: <http://www.ecb.int>.

Rezerva Federale: <http://www.federalreserve.gov/boarddocs/press/general/2001>.

⁴ Të gjitha llogaritjet janë në bazë vjetore. Të dhënat janë marrë nga botimet e FMN (WEO, Dhjetor 2001) dhe Buletini i Bankës Qendrore Gjermane, Janar 2002.

1.2. ZHVILLIMET NË EKONOMINË E BRENDSHME

1.2.1 Aktiviteti ekonomik dhe rritja ekonomike

Aktiviteti ekonomik i një vendi vlerësohet në bazë të informacionit statistikor të disponueshëm. Sa më i plotë, i detajuar dhe në kohë të jetë ky informacion, aq më të sakta dhe të dobishme janë analizat. Ekonomia shqiptare, duke qenë se nuk evidentohet nëpërmjet të dhënash të plota e të disponueshme në kohë, nuk mund të analizohet plotësisht dhe mjaft fenomene shpjegohen ose me vonesë ose në bazë të gjykimeve e vlerësimeve. Këtë vështirësi Banka e Shqipërisë e ndjen vazhdimisht, vështirësi e cila bëhet më e theksuar në tremujorin e fundit të çdo viti. Për këtë arsye, referencat kohore të të dhënave nuk janë të njëjta.

Të dhënat më të fundit të disponueshme të ekonomisë së brendshme tregojnë shenja të ngadalësimit të ritmeve të rritjes së prodhimit gjatë muajve të fundit të vitit 2001. Për këtë periudhë, mund të thuhet se situata e krijuar si pasojë e krizës energjitike vlerësohet të ketë dhënë efektet e saj negative si në sektorin shtetëror ashtu edhe në atë privat. Prodhimi i energjisë elektrike ka qenë mjaft më i ulët se ai i gjashtëmujorit të parë. Në tremujorin e katërt u prodhua vetëm 67 për qind e sasisë së programuar. Duke iu referuar treguesit kumulativ të muajit dhjetor 2001 "prodhimi mall i shitur", vërejmë se gjatë vitit 2001 industria ka prodhuar rreth 92 për qind të sasisë së prodhuar një vit më parë. Industria e metalurgjisë dhe ajo kimike kanë rritur prodhimin me 16 dhe 42 për qind në krahasim me vitin 2000, ndërkohë që industria e lëkurë-këpucëve dhe ajo e konfeksioneve kanë rënë me përkatësisht 7.6 dhe 61.2 për qind. Ecuria e këtyre dy industrive mendohet se ka ndikuar sadopak në ecurinë jo të kënaqshme të eksporteve.

Problemet më të mëdha duket se janë hasur në prodhimin e kromit dhe të ferrokromit. Mungesa e energjisë elektrike nga njëra anë dhe mungesa e një tregu për shitjen e prodhimit nga ana tjetër, kanë bërë që prodhimi i kromit gjatë vitit 2001 të jetë rreth 31 për qind më i ulët se ai i vitit 2000. Për arsyet e lartpërmendura në minierat e marra me qira në zonat e Kukësit, Tropojës dhe Hasit është ndërprerë krejtësisht prodhimi.

Të dhënat më të fundit nga bujqësia i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2001. Disa nga produktet prodhimi i të cilave ka njohur rritje gjatë kësaj periudhe janë pijet freskuese, uji natyral, birra, vera etj.. Gjatë kësaj periudhe është vënë re një rënie në prodhimin e miellit, të bukës, të ujit të gazuar etj.. Ndërkohë që prodhimi i miellit është rreth 33 për qind më i ulët nga ai i periudhës krahasuese të vitit 2000, importi i drithërave, mbi të njëjtën bazë krahasimi, është rritur me 18 për qind. Sipas parashikimeve, prodhimi bujqësor, ai i agroindustrisë dhe i peshkimit priten ta kalojnë me 3 deri në 7 për qind prodhimin sipas secilës degë krahasuar me vitin 2000.

Tregu i punës, sipas të dhënave më të fundit të disponueshme, nuk ka manifestuar ndryshime të konsiderueshme. Gjatë këtij gjashtëmujori ka vijuar si rënia e numrit të të papunëve, ashtu dhe e numrit të të punësuarve.


Tabelë 2: Tregues të tregut të punës⁵.

Punësimi (në mijë)	Gusht	Shtator	Tetor
Sektori shtetëror (në mijë)	197	194	194
Sektori privat bujqësor (në mijë)	761	761	761
Sektori privat jobujqësor (në mijë)	119	119	119
Numri i të punësuarve (në mijë)	1077	1074	1074
Të papunë (në mijë)	187	184	183
Përfitojnë pagesë (në mijë)	16	15	15
Kanë filluar punë gjatë muajit	490	259	956

1.2.2 Sektori i jashtëm

Të dhënat më të fundit nga tregtia e jashtme i përkasin muajit nëntor 2001. Tregtia e jashtme e Shqipërisë, gjatë periudhës në shqyrtim, ka demonstruar shenja rritjeje si në anën e importeve ashtu edhe në atë të eksporteve. Ky gjallërim i tregtisë u vu re kryesisht pas muajit gusht, i cili shënoi vlerat më të ulëta si në importe ashtu edhe në eksporte. Gjatë muajve korrik – nëntor vlera e importeve totale ka kapur shifrën 83.6 miliardë lekë, ndërsa ajo e eksporteve 16.5 miliardë lekë. Muajt me mbulimin më të lartë të importeve nga eksportet kanë qenë shtatori dhe nëntori me koeficientët 21.6 dhe 22.7 për qind. Gjatë muajit shtator është rritur veçanërisht importi i makinerive dhe pajisjeve si dhe ai i mjeteve të transportit. Në tetor janë shtuar importet e ushqimeve dhe ato të tekstileve, ndërsa nëntori, përveç importeve të rritura të makinerive dhe pajisjeve, ka sjellë në Shqipëri dhe sasi të mëdha artikujsh prej lëkure. Gjatë muajit nëntor janë eksportuar sasi të mëdha produktesh kimike dhe plastike si edhe makineri dhe pajisje.

Grafik 2: Ecuria e tregtisë së jashtme gjatë vitit 2001 (në miliardë lekë).



Bilanci i llogarisë korente për tremujorin e tretë të vitit 2001 është –84.3 milionë usd. Transaksionet totale të llogarisë korente për këtë tremujor kapën shifrën 832 milionë usd nga të cilat 374 milionë usd ishin të ardhurat dhe 458 milionë usd të dalat. Bilanci i shërbimeve gjatë këtij tremujori ishte pozitiv në

⁵ Burimi: Instat:- Muaji shkurtimisht Gusht-Tetor 2001.

nivelin 11.5 milionë usd; ai i të ardhurave 39.5 milionë usd dhe ai i transfertave 118.8 milionë usd.

Flukset hyrëse të kapitalit të këtij tremujori (61 milionë usd) kanë qenë shumë më të larta se ato të tremujorit paraardhës (31 milionë usd) dhe të atij të vitit të kaluar (20 milionë usd). Nga ana tjetër, shtylla e dytë e llogarisë kapitale dhe financiare, pra llogaria financiare, e mbylli tremujorin me një bilanc të ngushtë pozitiv (6 milionë usd). Ajo që bie në sy në llogarinë financiare është rënia, për të dytin tremujor rradhazi, e investimeve të huaja direkte. Këto investime janë rreth 45 për qind më të ulëta nga ato të tremujorit të tretë të vitit 2000 dhe 19 për qind më të ulëta nga ato të tremujorit paraardhës.


2. INFLACIONI

2. INFLACIONI NË GJASHTËMUJORIN E DYTË

2.1 Konsiderata të përgjithshme

Norma vjetore e inflacionit në fund të vitit 2001 arriti në 3.5 për qind, duke siguruar përmbushjen e objektivit të inflacionit për këtë vit. Mesatarisht, inflacioni vjetor qëndroi në nivelin 3.1 për qind dhe është rritur krahasuar me një vit më parë, kur treguesi ishte 0. Në përgjithësi, ecuria e çmimeve të konsumit gjatë gjithë vitit devijoi disi nga ecuria historike dhe ky fenomen ishte i pranishëm edhe në gjashtëmuJORIN e dytë.

Grafik 3: Ecuria e normës vjetore të inflacionit.




Bazuar në grupmallrat e ndryshëm rezulton se, në tërësi, inflacioni ndikohet më tepër nga ecuria e çmimeve në dy grupmallra “ushqim, pije dhe duhan”⁶ dhe “energji, qira, ujë dhe lëndë djegëse”. Ndërsa ecuria e inflacionit ndjek “më besnikërisht” ecurinë e çmimeve në grupin e parë, ndryshimi i fortë i çmimeve në grupin e dytë, në disa periudha, ka shkaktuar rritje të menjëhershme inflacionit.

Kështu, periudha e deflacionit në vitin 1999 dhe në gjysmën e parë të vitit 2000 i dedikohet reduktimit të ndjeshëm të çmimeve të ushqimeve. Rritja e inflacionit në gjysmën e dytë të vitit 2000 dhe gjatë gjithë vitit 2001, po ashtu, i dedikohet rritjes së çmimeve në këtë grupmall. Përveç kësaj, fundi i vitit 2000 dhe i vitit 2001 janë ndikuar edhe nga fenomenet e tipit *shock*, të shkaktuara përkatësisht nga rritja e çmimit të naftës në tregjet botërore dhe në tregun e brendshëm si dhe nga prezantimi i sistemit të ri të pagimit të energjisë elektrike (me dy nivele).


⁶ Rritja e çmimeve të mallrave në grupin “ushqim, pije, duhan” mund të jetë edhe më e lartë se sa evidentohet nga shifrat, si pasojë e mosrespektimit të standardeve të cilësisë së tyre. Më konkretisht, kjo është e evidente tek buka, çmimi i së cilës qëndron pothuaj i pandryshuar, megjithë ekzistencën e faktorëve që normalisht do të duhej të çonin në rritje çmimi.

Grafik 4: Kontributi i grupmallrave të IÇK tek inflacioni.



Krahas veprimit të faktorëve që çojnë në rritje të inflacionit nga kahu i ofertës, ndikim ka patur edhe veprimi i faktorëve nga kahu i kërkesës. Rritja e vazhdueshme e inflacionit bazë konfirmon që kërkesa agregate ka përbërë një burim konstant inflacioni. Ndër faktorët më të rëndësishëm mund të përmendim rritjen e ofertës monetare dhe të kredisë bankare mbi parashikimin.

Grafik 5: Ecuria e normës vjetore të inflacionit dhe inflacioni bazë.



Në kushte të tilla, megjithë vlerat e ulëta të inflacionit bazë, por duke vlerësuar nga ana tjetër faktorët nxitës që po vepronin apo pritëshin të vepronin, në rritjen e normës së inflacionit, Banka e Shqipërisë ndërhyri duke rritur normën bazë të interesit, në funksion të përmbushjes së objektivit të shpallur të saj për ruajtjen e inflacionit vjetor në kufijtë 2-4 për qind. Këshilli Mbikëqyrës i Bankës

së Shqipërisë, me vendimin nr. 72, datë 15.08.2001 rriti me **0.5 pikë përqindjeje normën e interesit të zbatuar në ankandet e repove** (nga 6.5 për qind në 7 për qind).

2.2. ZHVILLIMET NË INFLACION.

Inflacioni mujor gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2001, lëvizi në të njëjtin drejtim si dhe vitet e shkuara. Por, ai ka pësuar luhatje të dukshme nga mesataret disavjeçare. Në luhatjet mujore të normës së inflacionit, një pjesë i përket **efekteve sezonale** të kësaj periudhe. Kjo tregon se efektet sezonale vazhdojnë të ekzistojnë, por, në krahasim me gjashtëmujorët e dytë të viteve të tjera, gjashtëmujori i dytë i vitit 2001, u ndikua edhe nga shumë faktorë të tjerë të veçantë, që kishin ndikuar pak ose nuk kishin ndikuar më parë në zhvillimet inflacioniste.

Tabelë 3: Seritë mujore të inflacionit në gjashtëmujorët e dytë (në përqindje).

	1998	1999	2000	2001
Qershor	-1.72	-2.26	-2.08	-0.70
Korrik	-2.02	-1.34	-2.68	-1.20
Gusht	0.42	-0.23	0.43	-1.00
Shtator	1.45	0.09	1.70	1.10
Tetor	0.28	0.38	1.26	-0.45
Nëntor	0.18	0.8	0.83	1.90
Dhjetor	2.06	2.23	4.60	5.30


Dalohen tre periudha të zhvillimeve në çmimet e konsumit: periudha korrik-gusht kur inflacioni qëndroi në nivele të larta, madje duke tejkaluar objektivin; periudha shtator-tetor gjatë së cilës u vërejt një prirje rënëse e tij dhe periudha e fundit të vitit, kur inflacioni përsëri shënoi rritje të konsiderueshme.

Periudha e parë:

Në muajin korrik inflacioni e kaloi kufirin e sipërm të vlerës vjetore të objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ai arriti në vlerën 5.6 për qind krahasuar me korrikun e vitit 2000. Në rritjen e presioneve inflacioniste për këtë periudhë ndikuan kryesisht tensionet në FYROM si dhe efekti i shpenzimeve qeveritare.

Tensionet në FYROM, precipituan deri në trajtat e një konflikti të armatosur, duke kufizuar shkëmbimet tregtare me këtë vend. Importet e mallrave, sidomos ato të produkteve ushqimore, u ulën ndjeshëm. Ky fakt, ndikoi në ruajtjen në nivel relativisht të lartë (kur njihet efekti sezonal që vepron dukshëm në uljen e çmimeve në këtë periudhë) të çmimeve të produkteve bujqësore.

Grafik 6: Kontributi i nëngrupeve të “ushqim, pije, duhan” në inflacion.



Duke pasur parasysh faktin, që deri në momentin e shpërthimit të konfliktit, një pjesë e mirë importeve të mallrave të këtij nëngrupi kryhej me FYROM, efekti i tij në inflacion është i dukshëm. Gjithashtu, megjithëse nuk zë peshën kryesore në importin e këtyre mallrave, FYROM ofron lehtësi transporti më të shumta se vendet e tjera. Mallrat që importohen nga ky shtet ose nëpërmjet këtij shteti, u zëvendësuan me mallra të importuar nga shtete të tjera, gjë që solli dhe rritje të çmimeve.

Në këtë periudhë pati dhe një rritje të çmimeve të këtyre produkteve në tregun europian, e cila me siguri ka dhënë ndikimin e vet edhe në çmimet në vendin tonë. Duke qenë se kërkesa për këto produkte nuk arrin të plotësohet në tregun e brendshëm, Shqipëria importon produkte bujqësore nga vendet fqinje, në mënyrë të veçantë nga Italia dhe Greqia. Rritja e çmimeve në vendet kryesore partnere (për rastin e Greqisë shiko grafikun nr. 7) vlerësohet të ketë ndikuar në rritjen e çmimeve në tregun e brendshëm.

Fushata elektorale dhe zgjedhjet e përgjithshme politike të qershorit ndikuan, ashtu siç pritej nga tradita e ngjarjeve të tilla, në rritjen e shpenzimeve buxhetore dhe të elementeve spekulative. Rezultatja e pritur e këtyre faktorëve ishte rritja e inflacionit, që kulmoi në muajin korrik.

Tabelë 4: Shpenzimet buxhetore gjatë vitit 2001 (në milionë lekë).

Muajt	Shpenzimet buxhetore
Mars	13.776
Prill	13.271
Maj	15.406
Qershor	19.744
Korrik	15.920
Gusht	13.397
Shtator	14.373

Burimi: Ministria e Financave: "Statistikat fiskale të qeverisë".

Banka e Shqipërisë evidentoi në mënyrë empirike, si një faktor tjetër që ndikoi në shfaqjen e vlerave të larta të inflacionit vjetor në muajt qershor dhe korrik, **kursin e këmbimit** të lekut me monedhën amerikane dhe europiane. Nga tabela e mëposhtme shikohet qartë nënçmimi i lekut, që arriti në vlerat e tij më të ulëta kundrejt dollarit amerikan në muajin qershor.

Tabelë 5: Ecuria e kursit mesatar të këmbimit të lekut.

	Tremujori II	Qershor	Tremujori III	Tremujori IV	Dhjetor
Lek / usd	146.86	148.56	144.58	139.53	137.04
Lek / Euro	128.32	126.82	128.43	124.87	122.01

Disa nga faktorët e tjerë, që Banka e Shqipërisë evidentoi në kohë si faktorë presioni kundrejt inflacionit kishin të bënin me **pritjet inflacioniste**. *Yield*-et në rritje të bonove të thesarit, veçanërisht të bonove me afat maturimi të gjatë, situata energjitike, efektet e rritjes së pagave, vazhdimi i gjendjes së rënduar politike dhe financiare në rajon, përbënë në atë kohë një burim shqetësimi për Bankën e Shqipërisë, në drejtim të përmbushjes së objektivit kryesor të saj.

Periudha e dytë:

Situata në dy muajt që pasuan u karakterizua nga një intensitet më i ulët i faktorëve të ofertës, që kishin ndikuar në rritjen e normës së inflacionit duke sjellë zvogëlimin gradual të normës vjetore të inflacionit. Kjo situatë kulmoi në **muajin tetor**, kur inflacioni mujor shënoi një vlerë të pazakontë negative, ndërsa inflacioni vjetor zbriti poshtë kufirit të poshtëm të objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Faktorët që çuan në këtë sjellje tjetër të shifrës së inflacionit ishin:

- **Përmirësimi i aktivitetit të eksport-importit;** në muajin shtator, por sidomos në muajin tetor importet dhe eksportet pësuan një rritje të ndjeshme në krahasim me periudhën tremujore, qershor-gusht. Kjo çoi në **rritjen e ofertës**, që solli uljen e çmimeve të grupmallit "ushqim, pije e duhan". Indeksi i këtij grupi u ul me 0.7 për qind, gjë që ndikoi edhe në rënien, në masën 0.5 për qind, të IÇK.
- **Efekti i përqendrimit të lartë të shpenzimeve buxhetore,** të kryera në tremujorin e dytë të vitit 2001, **erdhi duke u zbehur.**

- **Rënia e çmimeve të produkteve bujqësore në tregun e brendshëm si pasojë e futjes në treg të prodhimeve sezonale vendase të vjeshtës, në mënyrë të veçantë në fund të muajit tetor.**
- **Rënia e çmimeve të naftës në tregjet botërore, pas sulmit terrorist të 11 shtatorit.**
- **Situata disi më e normalizuar në FYROM.**
- **Vendimi i Bankës së Shqipërisë për rritjen e përqindjeve të repove, ndikoi në pritshmërinë e publikut për inflacionin.**


Periudha e tretë:

Në përgjithësi, dy muajt e fundit të vitit kanë si tipar tendencën rritëse të normës mujore të inflacionit. Por, muajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2001, i kaluan kufijtë e pritshëm.

Muaji nëntor, u karakterizua nga një vlerë e inflacionit mujor rreth 0.9 pikë përqindjeje më e lartë sesa mesatarja shumëvjeçare. Në këtë muaj, filluan të duken efektet e para të disa faktorëve që ndikuan në kahun rritës të normës së inflacionit, dhe që vepruan me një intensitet më të madh në muajin dhjetor. Këta faktorë ishin:

- **Situata e rëndë energjitike**, që pati një ndikim të theksuar psikologjik tek popullata dhe u reflektua në rritjen e çmimeve, uljen e prodhimit dhe të shërbimeve.
- **Moti i keq**, i cili u shoqërua me rritje të çmimeve të produkteve ushqimore në disa zona të vendit si rrjedhojë e vështirësive për furnizim.
- **Rritja e çmimeve të produkteve bujqësore**, në mënyrë të veçantë në shtetin fqinjë, Greqi, nga e cila Shqipëria importon rreth 48 për qind të grupmallrave të grupit “ushqim, pije dhe duhan”. (Grafiku i mëposhtëm tregon një korrelacion të fortë të çmimeve të këtij grupi ndërmjet dy vendeve.)

Grafik 7: Krahasimi i çmimeve të ushqimeve të tregut shqiptar dhe atij grek (në %).



- **Situata e paqartë politike dhe, në mënyrë të veçantë ajo qeverisëse,** pati ndikim psikologjik në rritjen e çmimeve.
- Filloi të shfaqet, megjithëse jo në ato përmasa si të muajit dhjetor, **rritja spekulative e çmimeve,** si rezultat i faktorëve të përmendur më sipër.

Në muajin dhjetor të gjithë këta faktorë u shfaqën me intensitetin e tyre më të madh, që ndikoi në rritjen e dukshme të normës mujore të inflacionit.

Karakteristikë e këtij muaji ishte **rritja faktike e çmimit të energjisë elektrike,** që ndikoi drejtpërsëdrejti në rritjen pozitive të indeksit të grupit "qira, ujë, lëndë djegëse, energji" me ndikim një pikë përqindjeje në indeksin e çmimeve të konsumit.


Rritja e agregatëve monetare, ofertës monetare dhe parasë në qarkullim ndikoi në rritjen e inflacionit në këtë periudhë. Ndonëse vlen të theksohet fakti se normat e rritjes të shënuara gjatë muajit dhjetor paraqiten disi të shtrembëruara nga efekti që pati prezantimi i euros në thithjen e kursimeve valutore të popullsisë në sistemin bankar ose konvertimin e tyre në lekë, rritja e ofertës monetare përtej parashikimeve ka ndikuar në inflacion. Përvoja shqiptare tregon për shfaqjen e efektit të plotë të këtij faktori në horizontin kohor 1-3 muaj; likuiditeti i gjeneruar në këtë periudhë ka ndikuar në rritjen e vlerës së inflacionit në muajin janar.

Ndikimi i faktorëve të lartpërmendur me efekt në rritjen e inflacionit, nuk u arrit të kompensohej, nga ndikimi i faktorëve "zbutës" të tillë si:

- **mbiçmimi i dukshëm i lekut në muajin dhjetor** në krahasim me muajin paraardhës me rreth **2.23 për qind.** Në përgjithësi, pas muajit qershor, leku erdhi duke u mbiçmuar kundrejt monedhës amerikane derisa arriti kulmin e vet në muajin dhjetor në vlerën 137.04. Duke filluar nga muaji

tetor, u vu re dhe një ç'ekuilibrim i sjelljes simetrike të lekut kundrejt dy monedhave kryesore, dollarit amerikan dhe euros.

Grafik 8: Ecuria e kursit të këmbimit të lekut kundrejt usd dhe euros.



Megjithëse gjatë dhjetorit, fenomeni i mbiçmimit të lekut ishte i pranishëm, ai nuk ndikoi në masën që pritej në uljen e çmimeve. Ky fakt, konfirmon natyrën e tregut tonë, i cili është një rregullator i pafuqishëm i çmimeve në kahun zbritës;


- **mospërqendrimi i theksuar i shpenzimeve buxhetore në fund të vitit,** siç ka qenë e zakonshme në vitet e tjera.

SHTOJCA 1. PSE DEVIJOI INFLACIONI NË DHJETOR NGA PRITJET.

Në muajin dhjetor norma mujore e inflacionit ishte 5.3 për qind, ndërsa ajo vjetore në shifrat 3.5 për qind. Ky muaj konfirmoi pritshmëritë e Bankës së Shqipërisë për rritje të konsiderueshme të çmimeve të konsumit. Banka e Shqipërisë vëren që ky fenomen po përsëritet nga njëri vit në tjetrin, duke marrë dhe trajtat e një ngjarjeje të zakonshme të karakterit sezonal. Por, në mënyrë më të theksuar, ky fenomen është shfaqur në dy vitet e fundit. Për vitin 2001, megjithëse inflacioni vjetor ishte brenda kufijve të objektivit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, 2- 4 për qind, ai i kaloi pritjet, që ishin në kufijtë e 2-3 për qind.

Kjo gjë erdhi si **rezultat i rritjes**, kryesisht spekulative, **të çmimeve të grupit “ushqim pije dhe duhan”** duke përfutur nga rritja e dukshme e kërkesës me rastin e festave të fundvitit. Kështu, rritja e indeksit të çmimeve erdhi si rezultat i rritjes së çmimeve në këtë grup me 6.4 për qind duke dhënë një ndikim 4.4 për qind në rritjen e IÇK. Brenda këtij grupi, nëngrupi “fruta dhe perime” shënoi një rritje prej 19.8 për qind. Gjithashtu, në llogaritjen e dhjetorit nuk u futën në matjen e IÇK edhe të dhënat e çmimeve për javën e fundit të dhjetorit, gjë që do të ngrinte më tej përqindjen e inflacionit për muajin dhjetor.

Grafik 9: Ecuria e matjeve të ndryshme të inflacionit.



Karakteristikë e dhjetorit të vitit 2001 është **rritja e çmimit të energjisë elektrike** me 50 për qind për konsum mbi 300 kwh, që çoi në rritjen me 6.3 për qind të indeksit të grupit “ qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji”.

Gjatë muajit dhjetor, **rritja e ofertës monetare, parasë jashtë bankave dhe kredisë për ekonominë**, pati një përsheptim të ndjeshëm jashtë parashikimeve të Bankës së Shqipërisë. Megjithëse rritja e bilanceve të mjeteve monetare vepron në rritjen e çmimeve me një vonesë, që në rastin e Shqipërisë luhetet nga një deri në tre muaj, ajo ka ndikuar pa dyshim në rritjen e inflacionit në muajin dhjetor dhe do të vazhdojë të japë ndikimin e saj edhe në muajt në vazhdim.

Këta janë disa faktorë që bënë që inflacioni në muajin dhjetor të devijojë më shumë nga sjellja historike dhe të tejkalojë pritjen e Bankës së Shqipërisë.

3. POLITIKA MONETARE

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka qenë e orientuar plotësisht kah ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ndërkohë, edhe prezantimi i monedhës euro përbënte një sfidë për sistemin bankar, e cila nuk mund të qëndronte jashtë vëmendjes së Bankës së Shqipërisë.

Tendencat për mbiçmimin e lekut që shoqëruan procesin e konvertimit të monedhave të shportës në euro në muajin dhjetor, e detyruan Bankën e Shqipërisë të ndërhyjë në tregjet valutore për të shmangur pasojat e këtyre lëvizjeve, të konsideruara prej saj afatshkurtra dhe spekulative.

Ndërkohë, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar vëmendje rafinimit dhe koordinimit të kuadrit të instrumenteve të politikës monetare. Për këtë qëllim, në muajin shtator u prezantua një tjetër instrument, marrëveshjet e riblerjes me afat maturimi njëmuor. Duke mbuluar një boshllëk që ekziston në tregjet financiare shqiptare për instrumente më afatgjata maturimi, përdorimi i këtij instrumenti synonte tërheqjen e likuiditetit nga tregu për periudha më afatgjata, duke ndihmuar në rritjen e aktivitetit në tregun ndërbankar. Megjithatë, përdorimi i këtij instrumenti ka qenë i kufizuar.

3.1. OBJEKTIVAT SASIORË TË BANKËS SË SHQIPËRISË

Objektivat sasiorë të Bankës së Shqipërisë, edhe gjatë gjashtëmuorit të dytë rezultojnë të përmbushur.

Tabelë 6. Realizimi i objektivave sasiorë të Bankës së Shqipërisë⁷.

	Qershor '01			Shtator '01			Dhjetor '01		
	RNN	MBN	Kredia neto	RNN	MBN	Kredia neto	RNN	MBN	Kredia neto
Objektivi	213.1	64.2	213.1	480.7	62.7	222.1	484.6	71.5	231.1
Gjendja aktuale	213.1	64.2	213.1	499.1	61.6	220.0	545.6	69.5	229.5
Diferenca	0.0	0.0	0.0	18.3	-1.1	-2.1	61.0	-2.0	-1.6

Megjithë rritjen e huamarrjes së brendshme të qeverisë në gjashtëmuorin e dytë, kufiri i sipërm i rritjes së kredisë së brendshme neto ndaj qeverisë gjatë kësaj periudhe nuk është shkelur.

Rezervat valutore neto (RNN) të Bankës së Shqipërisë kanë qenë vazhdimisht mbi objektivin e tyre dhe në fund të vitit ato e kanë kaluar ndjeshëm këtë objektivi. Ndikimin kryesor në këtë tejkalim e ka blerja e një sasive të madhe valute nga ana e Bankës së Shqipërisë gjatë muajit dhjetor.

Edhe objektivi i tretë, ai i mjeteve të brendshme neto (MBN) të Bankës së Shqipërisë, është përmbushur. Megjithë rritjen e presioneve ndaj nivelit të

⁷ RNN janë të shprehura në milionë usd. MBN dhe kredia e brendshme neto për qeverinë janë të shprehura në miliardë lekë.

objektivit në muajin dhjetor, si pasojë e rritjes së kërkesës së qeverisë për financim dhe rritjes së bazës monetare në këtë periudhë, niveli i tyre rezultoi brenda objektivit.

3.2. INSTRUMENTET E POLITIKËS MONETARE

Banka e Shqipërisë ka vënë në shërbim të bankave të nivelit të dytë një sërë instrumentesh mbështetëse, si për furnizimin e tyre me likuiditete ashtu dhe për investimin e likuiditeteve të tepërta.

Kredia dhe depozita njëditore janë instrumente që përdoren nga ana e bankave për rregullimin e gjendjeve ditore të likuiditetit të tyre.

Sistemi bankar ka patur likuiditet të mjaftueshëm, të cilin e ka administruar në mënyrë të kujdesshme. Kjo ka bërë që, krahasuar me pjesën e parë të vitit⁸ 2001, ritmi i përdorimit të kredisë njëditore të jetë më i ulët. Për gjashtëmujorin e dytë kredia mesatare mujore ka qenë 0.8 miliardë lekë, ndërkohë që për gjashtëmujorin e parë mesatarja mujore ka qenë 1.7 miliardë lekë.

Ndërsa kredia njëditore përfaqëson një mjet për plotësimin e nevojave të bankave për likuiditete, depozita njëditore funksionon në kah të kundërt, në atë të investimit apo të tërheqjes së likuiditetit të tepërt nga sistemi bankar. Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2001, niveli kumulativ i depozitës njëditore për gjithë sistemin arriti shifrën 148.55 miliardë lekë. Mesatarisht, çdo muaj janë investuar në depozitë njëditore rreth 24.7 miliardë lekë, nivel ky, pothuajse i njëjtë me atë të gjashtëmujorit të parë, 24.5 miliardë.

Transaksionet e shitblerjeve me të drejta të plota. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2001 Banka e Shqipërisë shiti bono thesari nga portofoli i saj në masën 4 miliardë lekë. Qëllimi i këtij transaksioni ishte tërheqja e likuiditetit të tepërt nga sistemi. Rritja graduale e likuiditetit në sistemin bankar, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, erdhi si pasojë e kërkesës së ulët të qeverisë dhe kreditimit të ulët të ekonomisë në këtë periudhë. Banka e Shqipërisë, duke e konsideruar rritjen e likuiditetit të tepërt si pengesë në zbatimin efektiv të politikës së saj monetare, ndërhyri në uljen e nivelit të tij.

Marrëveshjet e riblerjeve njëmujore. Në muajin nëntor të vitit 2001 u mbajt ankandi për marrëveshjet e riblerjeve me afat maturimi njëmujor. Qëllimi i këtij transaksioni ishte tërheqja e përkohshme e likuiditetit të tepërt dhe rregullimi i nivelit të tij për sistemin. Vëllimi i këtij transaksioni ishte në masën 2 miliardë lekë dhe norma e interesit e ofruar nga pjesëmarrësit e ankandit luhatej nga 7.35 në 7.5 për qind.

Kredia Lombard. Në fund të këtij viti nga dy banka të sistemit u mor kredia lombard në masën 273 milionë lekë. Për vitin 2001, madje për disa vite me radhë, ky ishte rasti i parë i përdorimit të kësaj kredie, që konsiderohet si kredia më e shtrenjtë e vënë në dispozicion të bankave të nivelit të dytë.

⁸ Kredia njëditore filloi të përdorej në muajin maj të vitit 2001.

4. ZHVILLIMET MONETARE

Zhvillimet monetare gjatë gjysmës së dytë të vitit 2001 janë karakterizuar nga rritja e shpejtë e agregatëve monetarë. Rritja e kreditimit të ekonomisë, rritja shpejtë e depozitave në valutë, e cila u theksua në dhjetor si pasojë e efektit të euros, kanë sjellë gjatë vitit 2001 një rritje vjetore të agregatit M3 prej 19.9 për qind.

Megjithatë, politika monetare e kujdesshme e ndjekur nga Banka e Shqipërisë ka bërë të mundur që ajo të respektojë të tre objektivat e saj sasiorë, nivelin e sipërm të mjeteve të brendshme neto; të kredisë së brendshme për qeverinë dhe të kufirit të poshtëm për rezervat valutore neto të saj.

4.1 KËRKESA E EKONOMISË PËR PARA

4.1.1 Pozicioni valutor.

Gjashtëmujori i dytë i vitit 2001 ka sjellë një rritje të konsiderueshme të mjeteve valutore të sistemit bankar. Përtej rritjes së pritshme sipas tendencës historike të këtyre mjeteve, prezantimi fizik i monedhës së përbashkët europiane ka bërë që depozitat valutore në sistemin bankar të rriten ndjeshëm, veçanërisht në muajin dhjetor. Në terma relativë, rritja e mjeteve valutore neto të sistemit bankar, gjatë gjashtëmujorit të dytë, është rreth 7.8 për qind. Rritja reale e mjeteve valutore neto të sistemit bankar, e shprehur në dollarë amerikanë, është 18.3 për qind.

Megjithë pasigurinë e reagimit të popullsisë ndaj konvertimit fizik të monedhave përbërëse të shportës euro dhe përballjen e sistemit bankar me të, procesi i mësipërm vlerësohet të ketë kaluar pa probleme. Rezervat valutore të bankave tregtare janë rritur me 107 milionë usd si pasojë e rritjes së fluksit të depozitimeve në valutë, të nxitura edhe nga shmangia e komisioneve të konvertimit të monedhave të shportës në euro. Depozitat në valutë të publikut pranë bankave të nivelit të dytë u rritën përtej parashikimeve, veçanërisht në muajin dhjetor, duke kontribuar në rritjen e ndjeshme të ofertës monetare. Rezerva valutore bruto e Bankës së Shqipërisë është rritur me 85 milionë usd, duke bërë që niveli kumulativ i saj, në muajin dhjetor, të mbulonte 4.7 muaj importi mallrash dhe shërbimesh.

Procesi i konvertimit dhe efektet spekulative që e shoqëruan atë, duke iu bashkëngjitur faktorëve sezonalë, që tentojnë të sjellin një mbiçmim të lekut në fund të vitit, ushtruan një trysni të fortë për mbiçmimin e lekut në muajin dhjetor. Duke e konsideruar këtë prirje si një luhatje afatshkurtër nga kursi ekuilibër, me pasoja të dëmshme për ekonominë, Banka e Shqipërisë ndërhyri në tregun valutor për të kufizuar mbiçmimin e lekut gjatë muajit dhjetor. Kjo ndërhyrje solli rritjen e rezervave të saj valutore me rreth 40 milionë usd.

4.1.2 Kredia e brendshme.

Kredia për qeverinë.

Në përgjithësi, treguesit kryesorë fiskalë, të ardhurat, shpenzimet dhe deficitit buxhetor kanë qenë brenda niveleve të programuara. Megjithë vështirësitë e krijuara nga situata energjitime deficitit buxhetor vlerësohet të ketë arritur në 9 për qind të të ardhurave kombëtare, duke vazhduar të ndjekë linjën rënëse të dy viteve të fundit. Progresi dhe konsolidimi në sektorin fiskal, manifestohen në rënien e peshës së deficitit buxhetor ndaj PBB-së, nga 11.4 për qind në vitin 1999, në 9.1 për qind në vitin 2000 dhe 9.0 për qind në vitin 2001.

Ndërkohë, ritmika jo e njëtrajtshme e shpërndarjes mujore të shpenzimeve dhe burimeve të financimit të deficitit, vazhdon të përbëjë një problem për ekonominë shqiptare. Duke gjeneruar “minicikle” ekonomike dhe duke shkaktuar luhatje afatshkurtra të treguesve makroekonomikë, ato vështirësojnë parashikimin dhe interpretimin e gjendjes makroekonomike.

Megjithatë, duhet thënë se fenomeni i njohur i përqendrimit të shpenzimeve buxhetore në tremujorin e fundit të vitit, dhe veçanërisht në muajin dhjetor, ishte më i zbutur këtë vit. Zhvillimet fiskale, sidomos në kahun e shpenzimeve, në gjashtëmujorin e parë, ndikuan në ecurinë e këtyre treguesve edhe në gjashtëmujorin e dytë. Rritja e shpenzimeve kapitale të buxhetit në periudhën maj-korrik, lehtësoi intensitetin e përqendrimit të shpenzimeve në muajt e fundit të vitit. Kjo lehtësoi kufizimin e përqendrimit të shpenzimeve në ekonomi në këtë periudhë, duke kontribuar në analizë të fundit në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Ndërkohë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për burimet e financimit të deficitit. Një burim të rëndësishëm në mbulimin e deficitit buxhetor kanë përbërë të ardhurat e privatizimit, të cilat vlerësohet të kenë arritur në 2.1 për qind të PBB-së, dhe të financimit të huaj, që vlerësohet të ketë arritur në 0.8 për qind të PBB-së. Por, këto burime ishin më të pranishme në pjesën e parë të vitit, gjatë të cilit u përdorën 77 për qind e të ardhurave nga privatizimi. Kjo ka bërë që financimi i sistemit bankar për këtë periudhë të jetë negativ. Në gjashtëmujorin e dytë, qeveria është mbështetur në huamarrjen e brendshme. Kështu, rritja e pretendimeve neto të sistemit bankar ndaj qeverisë arriti në 18.5 miliardë lekë, ndërkohë që rritja vjetore e këtyre pretendimeve është 15.5 miliardë lekë.

Kredia për ekonominë.

Roli i sistemit bankar si një ndërmjetës financiar në alokimin e fondeve drejt sektorëve produktivë të ekonomisë ka ardhur në rritje gjatë vitit 2001. Kreditimi i ekonomisë i tejkaloi parashikimet e Bankës së Shqipërisë. Rritja e tepricës së kredisë për ekonominë gjatë vitit 2001 ishte 10.7 miliardë lekë, kundrejt një parashikimi për një rritje prej 6.8 miliardë lekësh të saj. Nga kjo rritje totale, 8 miliardë lekë ose pothuaj 75 për qind e rritjes vjetore, është verifikuar në gjashtëmujorin e dytë duke dëshmuar për një përmirësim të lidhjes së sektorit bankar me sektorët prodhues të ekonomisë.

Gjithashtu, duhet thënë se ndjekja e një politike të ekuilibruar fiskale, e shoqëruar me uljen e kërkesës për financimin e deficitit nga sistemi bankar, ka krijuar më shumë hapësira për rritjen e kreditimit të ekonomisë. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, është rritur pesha e financimit të ekonomisë duke reduktuar financimin e qeverisë⁹.

Tabelë 7. Shpërndarja e fondeve të sistemit bankar (në përqindje ndaj M3).

	1998	1999	2000	Mars '01	Qershor '01	Shtator '01	Dhjetor '01
Kredi e brendshme	90.8	80.3	76.3	74.1	71.4	70.5	70.1
Kredi për qeverinë	82.9	73.5	68.4	66.3	63.2	61.9	60.8
Kredi për ekonominë	7.9	6.8	7.9	7.8	8.2	8.6	9.3

Tendencat pozitive të procesit të kreditimit në gjashtëmujorin e dytë ishin të dukshme edhe në nivelin e kredisë së re të akorduar. Kredia e re e dhënë gjatë këtij gjashtëmujori, ishte 27.7 miliardë lekë kundrejt 12.9 miliardë lekësh në gjashtëmujorin e parë. Muaji dhjetor, gjatë të cilit u akordua pothuaj 30 për qind e kredisë së re të gjashtëmujorit, është muaji me nivelin më të lartë të lëvrimit të kredive të reja gjatë gjithë vitit 2001.

Kreditimi i ekonomisë edhe gjatë gjashtëmujorit të dytë vazhdon të shfaqë karakteristika tashmë të njohura. Tregu shqiptar i kredidhënies vazhdon të mbetet i fragmentarizuar dhe konkurrenca në të, e kufizuar. Ky treg reflekton dobësitë strukturore të vetë ekonomisë shqiptare. Mjafton të theksojmë faktin se 79 për qind e kredisë së akorduar në muajin dhjetor i takon vetëm 2 bankave, duke treguar kështu një përqendrim në tregun e huadhënies.

Kredia afatshkurtër vazhdon të përbëjë pjesën më të madhe të kredidhënies, madje pesha e saj ndaj totalit të kredisë ka patur rritje.

⁹ Për efekte analize dhe krahasimi, raportet dhe flukset e ndryshimeve të përmendura në këtë seksion nuk mbajnë parasysh efektet kontabile të transferimit pranë ATK të një pjese të tepricës së kredive me probleme të sistemit bankar.

Tabelë 8. Struktura e kredisë së re (në përqindje).

	T 1	T 2	T 3	T 4
Kredi afatshkurtër	62	65	66	73
Kredi afatmesme	25	30	29	21
Kredi afatgjatë	13	5	5	6
Sektori shtetëror	5	2	0	0.3
Sektori privat	95	98	100	99.7
Lekë	23	28	17	30
Valutë	77	72	83	70

Tabelë 9. Struktura e tepricës së kredisë (në përqindje).

	T 1	T 2	T 3	T 4
Kredi afatshkurtër	39	42	46	53
Kredi afatmesme	32	31	29	25
Kredi afatgjatë	29	27	25	22
Sektori shtetëror	10	9	5	5
Sektori privat	90	91	95	95
Lekë	42	41	36	35
Valutë	58	59	64	65

Kredia në valutë vazhdon të jetë forma kryesore e kredidhënies. Kështu, gjatë këtij gjashtëmujori, nga 27.7 miliardë lekë kredi e re vetëm në valutë është dhënë 21 miliardë lekë (afërsisht 150 milionë dollarë amerikanë). Arsyeja kryesore që preferenca për kreditë në valutë vazhdon të mbizotërojë dukshëm është fakti se normat e tyre të interesit janë më të ulëta se ato në lekë. Megjithatë, një shpjegim i tillë duhet lidhur dhe me shkallën e "dollarizimit" të ekonomisë shqiptare, për vetë faktin se normat e ulëta të depozitave në valutë nuk përbëjnë pengesë për rritjen e shpejtë të tyre.

Megjithëse normat e interesit të kredive janë shumë të ndryshme nga njëra bankë në tjetrën vihet re se interesi i ponderuar si sistem bankar për kreditë e akorduara në lekë është shoqëruar nga një tendencë rënëse gjatë vitit 2001. Interesi i ponderuar si sistem bankar për kreditë e akorduara në lekë, krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar, u shoqërua me një tendencë të theksuar rënëse prej 10.37 pikë përqindjeje (tabela 10). Nga ana tjetër, midis muajve përbërës të vitit 2001, interesi i ponderuar për kreditë e akorduara në lekë paraqitet herë në rritje e herë në rënie. Një situatë e tillë e forcon idenë se nuk ka një normë të qëndrueshme tregu për kredinë në lekë.

Tabelë 10. Normat e interesit të ponderuar për kreditë në lekë (në përqindje).

	Dhje. '99	Dhje. '00	Mar. '01	Qer. '01	Shtat. '01	Dhje. '01
0 – 6 muaj	21.7	21.2	20.9	24.0	14.6	15.3
6m-1vit	25.8	23.7	16.1	14.0	13.9	11.9
1-3 vjet	26.8	23.7	22.2	14.6	18.2	18.5
mbi 3 vjet	22.2	27.0	15.6	15.2	17.0	-
Totali	25.5	23.6	17.6	14.4	14.7	13.2

E njëjta tendencë vihet re dhe për normat e interesit të kredive të akorduara në valutë. Rënia e interesave për kreditë në valutë lidhet kryesisht me rënien e normave të interesit të valutës në tregjet ndërkombëtare.

Tabelë 11. Normat e interesit për kreditë e akorduara në usd dhe euro¹⁰.

	Mars	Qershor	Shtator	Dhjetor
Në usd	9.5	10.3	7.5	8.4
Në euro	8.2	7.6	6.6	7.3

4.2. OFERTA MONETARE

Gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2001, norma e rritjes vjetore të ofertës monetare ka qenë vazhdimisht¹¹ më e lartë sesa norma e parashikuar e rritjes vjetore. Duke ndjekur zhvillimet monetare, në muajin tetor, Banka e Shqipërisë bëri rishikimin e programit monetar duke e ndryshuar projeksionin e rritjes së M3 për fundvitin, nga 11.3 për qind në 15.4 për qind. Megjithatë, në muajin dhjetor norma aktuale e kësaj rritjeje rezultoi të ishte 19.9 për qind.


Kontributin më të madh në rritjen e ofertës monetare gjatë gjysmës së dytë të vitit e ka dhënë paraja jashtë bankave dhe depozitat në valutë, ndërsa pesha e depozitave në lekë ka ardhur duke u zvogëluar.

Norma vjetore e rritjes së parasë jashtë bankave, në fund të vitit arriti në 20.0 për qind, duke qenë praktikisht në të njëjtin nivel me normën e rritjes së ofertës monetare. Kulmet e rritjes së saj, paraja jashtë bankave i pati në periudhën qershor-korrik dhe në muajin dhjetor. Vetëm në dhjetor ky tregues pati një rritje prej 12 miliardë lekësh, kryesisht si pasojë e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregjet valutore, ndërkohë që, në terma absolutë, rritja vjetore e parasë jashtë bankave është 19.9 miliardë lekë. Rritja e parasë jashtë bankave në muajt qershor-korrik erdhi si rezultat i rritjes së shpenzimeve të qeverisë në këtë periudhë, që përkoi me zgjedhjet parlamentare në vend. Në muajt në vazhdim, ritmi i rritjes vjetore të parasë jashtë bankave u normalizua duke iu afruar vlerave të gjashtëmujorit të parë si pasojë e uljes së presioneve për financim të qeverisë. Pesha e saj në M3 erdhi, gjithashtu, duke u ulur deri në muajin dhjetor. Megjithatë, agregati M3 vazhdoi të rritej përtej normës së pritur si rezultat i rritjes së depozitave, kryesisht i atyre në valutë.

¹⁰ Normat janë norma mesatare të ponderuara.

¹¹ Me përjashtim të muajit gusht.

Grafik 10. Rritja vjetore e përbërësve monetarë.



Depozitat në lekë kanë demonstruar ritme të ulëta rritjeje krahasuar me treguesit e tjerë monetarë. Peshë e tyre në M3 ka zbritur nga 50.1 për qind, që ishte në maj, në 47.3 për qind në dhjetor. Ndonëse Banka e Shqipërisë rriti normën e interesit për repot në muajin gusht, bankat e nivelit të dytë, sidomos Banka e Kursimeve, e cila ka peshën më të madhe të depozitave në lekë, janë treguar pasive në rritjen e interesave për depozitat. Si rrjedhim, nxitja për të mbajtur kursimet në formën e depozitave në lekë mund të ketë patur ulje, sidomos në prani të rritjes së normës së inflacionit, gjë që ka sjellë uljen e kthimit real të depozitave në lekë. Megjithatë, pas gushtit, duket se paraja në qarkullim është kthyer në sistem në formën e depozitave dhe nëntori shënon edhe rritjen më të lartë mujore të depozitave në lekë që nga muaji shkurt¹² (1.7 për qind).

Rritja e depozitave në valutë ka vazhduar edhe gjatë pjesës së dytë të vitit. Pas uljes së nivelit të tyre në muajin qershor, ku ndikoi pjesërisht mbiçmimi i monedhës vendase, në muajt në vazhdim peshë e tyre në M3 është rritur nga 20.9 për qind në 22.4 për qind në fund të vitit. Depozitat në valutë kanë shfaqur një tendencë rritëse që në fillim të vitit duke pasqyruar një preferencë të publikut shqiptar për t'i ruajtur kursimet e tyre në monedhë të huaj. Kjo tendencë nuk është ndikuar as nga luhajtjet e kurseve të këmbimit që kanë favorizuar mbiçmimin e lekut.

Në muajin dhjetor, megjithë ndikimin zbutës që solli mbiçmimi i lekut në depozitat në valutë, këto u rritën me 8.9 për qind ose me 7.2 miliardë lekë krahasuar me muajin paraardhës, kur në program ishte parashikuar një rritje vetëm prej 1.8 miliardë lekësh. Duke hequr efektin e kursit të këmbimit, rritja mujore e depozitave në valutë në dhjetor do të ishte 10.7 për qind. Në terma vjetorë, ato u rritën me 38.7 për qind, norma më e lartë e rritjes vjetore gjatë dy viteve të fundit. Arsyeja kryesore e rritjes së tyre kishte të bënte me hyrjen fizike të euros dhe me mundësinë që i dhanë bankat e nivelit të dytë publikut për të konvertuar monedhat e shportës së euros në këtë të fundit pa komision

¹² Në terma vjetorë, kjo ishte rritja më e madhe gjatë gjithë vitit, 13.6 për qind.

deri në fund të dhjetorit. Mundësia e konvertimit të monedhave të shportës euro, nëpërmjet depozitimit të tyre në bankat tregtare, krijoi mundësinë e thithjes së valutës që qarkullonte jashtë sistemit bankar.

4.2.1. Baza monetare.

Niveli i bazës monetare u rrit ndjeshëm në muajin qershor si rezultat i rritjes së parasë jashtë bankave dhe rezervave të tepërta të sistemit bankar, si përbërësit kryesorë të saj. Në muajt në vazhdim e deri në nëntor, baza monetare ka qëndruar pak a shumë në të njëjtat nivele, duke reflektuar luhatjet e parasë jashtë bankave dhe nivelin e ulët të rezervave të tepërta. Në qëndrueshmërinë e këtyre niveleve ka ndikuar kërkesa e ulët e qeverisë për financimin e deficitit buxhetor nga sistemi bankar si edhe ndryshimi i formës së ankandit të repove.

Rritja e parasë jashtë bankave në dhjetor bëri që norma vjetore e rritjes së bazës monetare të kalojë në 18.1 për qind, nga 13 për qind në nëntor.

SHTOJCA 2. OFERTA MONETARE DHE NDIKIMI I SAJ NË INFLACION GJATË VITIT 2001.

Banka e Shqipërisë, në përmbushjen e objektivit të saj final, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, i kushton një vëmendje prioritare treguesve monetarë. Njohja e një roli parësor për agregatët monetarë në hartimin dhe vlerësimin e politikës monetare mbështetet si në teorinë ekonomike dhe në përvojën e ekonomisë shqiptare me inflacionin. Më konkretisht, rritja e masës monetare përtej kërkesës reale të ekonomisë për mjete monetare, është provuar se është një premisë për shfaqjen e inflacionit.

Në programimin e ritmit të rritjes së ofertës monetare, Banka e Shqipërisë nisat pikërisht nga parashikimi i kërkesës së ekonomisë për mjete monetare. Si përafrim i parë shërben niveli i rritjes ekonomike të një vendi: shmangiet midis ritmit të rritjes së ofertës monetare dhe ritmit të rritjes ekonomike janë premisë për ndryshimin e nivelit të çmimeve në ekonomi. Megjithatë, fortësia dhe koherenca e një lidhjeje të tillë nuk është provuar gjithnjë në vendet në tranzicion. Ndryshimi i strukturës së ekonomisë dhe problemet në matjen dhe në vlerësimin e shumë variablave ekonomike e bëjnë të paqëndrueshme këtë lidhje. Këto ndryshime pasqyrohen në "shpejtësinë e qarkullimit të parasë"; term ky i përdorur për të matur raportin e PBB-së nominale me ofertën monetare, agregatin M3. Me fjalë të tjera, shpejtësia e qarkullimit të parasë është një matës i kërkesës së ekonomisë për para reale, duke patur një lidhje inverse me të.

Gjysma e dytë e vitit 2001 konfirmoi më tej rritjen e shpejtë të ofertës monetare dhe uljen e shpejtësisë së qarkullimit të parasë, që ishte vërejtur edhe në gjashtëmujorin e parë. Rritja vjetore e agregatit M3 arriti në 19.9 për qind në fund të vitit, duke tejkaluar ndjeshëm parashikimin e Bankës së Shqipërisë për rritjen vjetore të saj në nivelin 15.4 për qind, ndërsa shpejtësia e qarkullimit të parasë zbriti nga 1.62 në 1.51 gjatë vitit 2001. Megjithatë, inflacioni vjetor 3.5 për qind ishte brenda objektivit të Bankës së Shqipërisë.

Studimet ekonometrike për Shqipërinë tregojnë se një rritje e M3 e jep efektin e vet në inflacion me një vonesë prej 1-3 muajsh. Periudhat me inflacion të lartë janë

shoqëruar me rritje të shpejtë të ofertës monetare, dhe veçanërisht të komponentëve më likuidë të saj: parasë jashtë bankave dhe agregatit M1. Gjatë dy viteve të fundit agregati M1 ka ndjekur më nga afër lëvizjet në inflacion se oferta monetare. Momentet kulmore të inflacionit gjatë vitit të fundit, dhjetori i vjetshëm dhe muajt qershor-korrik të këtij viti janë shoqëruar me rritje të shpejtë të M1.

Rritja e lartë e ofertës monetare duket se shkakun kryesor e ka në rritjen e kërkesës së ekonomisë për mjete monetare. Banka e Shqipërisë ka ndjekur një politikë të matur monetare, duke kontrolluar likuiditetin e gjeneruar prej saj dhe duke tërhequr në vazhdimësi likuiditetin e tepërt të sistemit bankar. Në mënyrë të përmbledhur arsyet kryesore të rritjes së ofertës monetare janë:

- **Kërkesa e ekonomisë për mjete monetare.** Rritja e kreditimit të ekonomisë, gjatë vitit 2001, i tejkaloi parashikimet. Krahasuar me vitin 2000, ajo kompensoi plotësisht uljen e kërkesës së qeverisë për financimin e deficitit të saj buxhetor, duke ruajtur kërkesën për fonde nga sistemi bankar në të njëjtin nivel me vitin e kaluar.
- **Rritja e vazhdueshme e depozitave në valutë.** Rritja e këtyre depozitave përbën 34 për qind të rritjes së ofertës monetare gjatë vitit 2001. Kjo rritje tregon se në ekonominë shqiptare ka një sasi të madhe mjetesh monetare të huaja, të cilat duken se burimin kryesor e kanë në dërgesat e emigrantëve shqiptarë që punojnë jashtë atdheut. Stabiliteti i tregueve makroekonomikë dhe forcimi i besimit të publikut në sistemin bankar bën që ky i fundit të tërheqë një pjesë gjithnjë e më të madhe të këtyre mjeteve, në formën e depozitave. Intensiteti i veprimit të këtij fenomeni shënoi rritje gjatë vitit 2001, megjithë rënien e vazhdueshme të normave të interesit të depozitave në valutë. Pesha e depozitave në valutë ndaj ofertës monetare u rrit me 2 pikë përqindjeje gjatë vitit 2001, duke kaluar nga 19.4 për qind në 21.4 për qind.
- **Efekti i prezantimit fizik të euros.** Një faktor më specifik, i cili veproi në muajt e fundit të vitit ishte prezantimi i euros fizike. Ky proces u shoqërua me rritjen e ndjeshme të depozitave në valutë në muajin dhjetor dhe me ndërhyrjen e Bankës së Shqipërisë në tregjet valutore, për të penguar mbiçmimin e fortë të lekut në këtë periudhë. Nën veprimin e këtyre faktorëve, norma vjetore e rritjes së M3 kaloi nga 17.1 për qind në nëntor, në 19.9 për qind në dhjetor. Kjo bëri që një masë e madhe e valutës së huaj, e pranishme në ekonominë shqiptare dhe më parë, të drejtohej në sistemin bankar duke u bërë "e dukshme". Këto mjete monetare kanë qenë të pranishme në ekonominë shqiptare dhe më parë, pavarësisht se nuk figuronin në statistikat monetare, dhe për këtë arsye rritja e ofertës monetare si pasojë e ndikimit të tyre nuk pritet të ndikojë ndjeshëm në inflacion.

Normat e larta të rritjes së M3 gjatë gjashtëmuajorit të dytë, me një shmangie të ndjeshme nga nivelet historike të tyre, nuk janë shoqëruar me rritje të fortë të inflacionit. Duke përjashtuar treguesit e muajit dhjetor, dhe veçanërisht rritjen e parasë jashtë bankave në këtë muaj si pasojë e prezantimit të euros, rritja e ofertës monetare ka marrë, në masën më të madhe, formën e rritjes së depozitave, pra të aktiveve monetare më pak likuide. Raporti mesatar i parasë jashtë bankave ndaj ofertës monetare për vitin 2001, gjatë 11 muajve të parë të vitit, ishte 28.8 për qind, ndërkohë që në muajin dhjetor ai arriti në 30.3 për qind. Kjo ka kontribuar në kufizimin e presioneve inflacioniste, me burim rritjen e mjeteve monetare, gjatë vitit 2001.


Megjithatë, nuk duhet përjashtuar ndikimi në inflacion i rritjes së ofertës monetare, sidomos në muajin dhjetor. Duke patur parasysh dhe diferencën kohore 1 – 3 muajshe që rritja e ofertës monetare ndikon në inflacion, gjatë tremujorit të parë të vitit 2002 duhet pritur një ndikim i fortë i rritjes së ofertës monetare, dhe veçanërisht i parësë jashtë bankave, në inflacion. Të dhënat e muajit janar, ku norma mujore e inflacionit arriti në 1.53 për qind e konfirmojnë këtë shqetësim të Bankës së Shqipërisë.

4.3. TREGJET E PARASË

Për të eliminuar presionet në uljen e normave të interesit të depozitave në lekë, Banka e Shqipërisë vazhdoi të kryejë ankandet e marrëveshjeve të riblerjeve me normë interesi të përcaktuar dhe me shumë të pakufizuar, duke patur për qëllim uljen e rezervave të tepërta në sistem. Megjithëse, rezervat e tepërta kanë pësuar një zvogëlim të dukshëm, nga rreth 14 miliardë në fund të muajit qershor në rreth 4 miliardë në fund të muajit dhjetor, ndikimi i tyre në normën e interesit të depozitave¹³ në lekë ka qenë mjaft i vogël, vetëm me 0.07 për qind nga qershori në dhjetor.

Vendimi i Bankës së Shqipërisë për rritjen e normave të interesit u reflektua menjëherë në tregun primar të bonove të thesarit, norma e interesit të të cilit, për bonot me afat maturimi tremujor u rrit me 0.5 për qind. Ky efekt rritës vijoi në rritjen e normave të interesit në tregun ndërbankar si për transaksionet njëditore ashtu dhe për ato shtatëditore e më shumë.


Grafik 11. Rezervat e tepërta të sistemit dhe përbërja e tyre.



¹³ Bëhet fjalë për normën mesatare të ponderuar të pranimeve të reja të depozitave në lekë për gjithë sistemin bankar.

Megjithëse, tregu ndërbankar reagoi mirë ndaj ndryshimit të kursit të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, bankat e sistemit vazhdonin të ofronin norma interesi për depozitat në lekë në nivele pothuajse të njëjta me ato të parandryshimit të normës së repove. Por, kjo është më tepër pasojë e dominimit të tregut nga Banka e Kursimeve, e cila i mbajti të pandryshuara normat e interesit. Bankat private u treguan më aktive në rritjen e tyre. Pra, mund të thuhet se politika e ndjekur nga Banka e Shqipërisë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2001, arriti të ndalojë uljen e mëtejshme të normës së interesit të depozitave në lekë që karakterizoi këtë segment të tregut të parasë në gjashtëmuorin e parë.


Grafik 12. Ecuria e normave të interesit në ekonomi.



Tregu primar i bonove të thesarit gjatë këtij gjashtëmuorin nuk paraqet ndryshim përse i përket pjesëmarrësve të tij. Bankat e sistemit vazhdojnë ta konsiderojnë atë një alternativë të mirë investimi. Duhet përmendur që Banka e Kursimeve vazhdon të kryesojë tregun primar. Ndërkohë, një zhvillim pozitiv në tregun primar të bonove të thesarit është rritja e pjesëmarrjes së individëve në këtë treg. Gjatë vitit 2001, portofoli i individëve është rritur me pothuaj 40 për qind, duke ju përgjigjur kështu synimit të Bankës së Shqipërisë për zgjerimin e aktorëve në tregun e bonove të thesarit, si një premisë për rritjen e efektivitetit të tyre.

Yield-i i bonove të thesarit në gjashtëmuorin e dytë të këtij viti, pas rritjes prej rreth 0.5 për qind për të tre maturitetet, në fillim të muajit shtator, tenton të mos lëvizë dhe të ruajë të njëjtat nivele deri në fund të muajit dhjetor. Drejtues kryesor i lëvizjes së *yield*-it të bonove të thesarit në treg ka qenë Banka e Kursimeve.


Grafik 13. Yield-i i bonove të thesarit.



Vëllimi i transaksioneve në **tregun ndërbankar** për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2001, kapi shifrën 18.06 miliardë lekë. Në terma relativë, ky nivel transaksionesh është rreth 2.4 herë më i lartë se në gjashtëmujorin e parë. Karakteristikë e tregut ndërbankar në këtë gjashtëmujor ka qenë dinamizmi i tij dhe aktivizimi më i madh i bankave të nivelit të dytë në të, si përsa i përket numrit ashtu dhe vëllimit të transaksioneve në treg.

Norma e interesit në tregun ndërbankar ka reflektuar qartë lëvizjen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjeve shtatëditore. Pas një qetësie në normat e interesit të tregut ndërbankar gjatë muajit korrik, rritja e normës së interesit të repove në muajin gusht ndikoi drejtpërsëdrejti normën e interesit të këtij tregu. Siç pasqyrohet grafikisht më poshtë, kjo normë për këtë gjashtëmujor luhatet në intervalin 4.45 – 5 për qind.

Grafik 14. Normat e interesit në tregun ndërbankar



5. PERSPEKTIVAT E AFËRTA TË ZHVILLIMIT EKONOMIK

5.1. ZHVILLIMET E PRITSHME INFLACIONISTE.

Gjatë vitit 2002 Banka e Shqipërisë do të mbajë të pandryshuar objektivin e saj për rritjen e inflacionit vjetor, duke synuar të ruajë rritjen e çmimeve të konsumit në ekonomi brenda një intervali 2 – 4 për qind.

Indeksi i çmimeve të konsumit vazhdoi rritjen edhe në muajin janar. Vlera mujore e inflacionit ishte 1.53 për qind¹⁴, duke tejkaluar përsëri vlerën e pritur prej 0.9 për qind.

Ndër faktorët që ndikuan në shifrën e lartë të janarit është mungesa e energjisë elektrike, e cila po kthehet në një faktor të përhershëm negativ për gjithë ekonominë shqiptare, duke rritur koston aktuale të saj dhe duke sjellë rritje çmimesh. Gjithashtu, rritja e inflacionit në muajin janar, është ndikuar edhe nga rritja e shpenzimeve buxhetore në muajin dhjetor, të cilat ishin sa dyfishi i shpenzimeve të muajit nëntor.

Norma relativisht e lartë e inflacionit në muajin janar në vendet e Bashkimit Europian, e cila ka ardhur si rezultat i temperaturave të ftohta, që kushtëzuan prodhimet bujqësore dhe nga prezantimi i euros fizike në tregje, ndikoi në çmimet e produkteve ushqimore në tregun shqiptar. Megjithëse llogaritja e IÇK-së është bërë më shportën e re, ku grupi “ushqim, pije dhe duhan” zë një peshë shumë më të vogël në krahasim më llogaritjen e vjetër të IÇK, përsëri rritja e çmimeve të ushqimeve në tregun ndërkombëtar ka ndikuar së tepërmi në këtë vlerë të lartë të muajit janar.

Për tremujorin e parë të këtij viti, pritet të kemi një situatë të ngjashme me atë të janarit, për faktin se faktorët shtytës të sipërpërmendur vazhdojnë të veprojnë me intensitet mbi ekonominë shqiptare.

Megjithatë, zhvillimet ciklike shumëvjeçare të inflacionit në Shqipëri, por sidomos ato të viteve të fundit, sugjerojnë se duke filluar nga muaji shkurt inflacioni do të fillojë të ketë rënie. Kjo edhe për faktin se vlera inflacioniste e janarit është një vlerë tepër e lartë dhe mendohet të jetë maja e zhvillimeve të periudhës së dytë inflacioniste, që siç e theksuam filloi në muajin nëntor të vitit të kaluar.

Dukuria e rënies së kërkesës konsumatore me kalimin e festave do të çojë në stabilizimin e çmimeve, në mënyrë të veçantë të grupmallit “ushqim, pije dhe duhan”. Shenjat e para të rënies së çmimeve u dhanë në dy javët e fundit të muajit janar dhe vazhduan edhe gjatë muajit shkurt.

Banka e Shqipërisë pret që situata e çmimeve të hyjë në ecurinë e vet normale sezonale pas muajit shkurt të vitit 2002.

¹⁴ Llogaritjet janë me shportën e re. Shifrat përfundimtare janë ende në përpunim dhe ende të pabotuara nga INSTAT.

5.2. PERSPEKTIVAT E TREGUESVE TË TJERË MAKROEKONOMIKË

Edhe në horizontin kohor afatmesëm, kuadri i programuar i zhvillimit ekonomik të vendit e vendos theksin në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik. Politika fiskale dhe ajo monetare do të jenë të orientuara pikërisht kah ruajtja e stabilitetit të arritur gjatë kësaj periudhe. Parashikimet fillestare flasin për një vazhdim të ritmeve të shpejta të rritjes edhe gjatë vitit 2002. Duke u mbështetur në sektorët më dinamikë të ekonomisë, ndërtim, transport dhe shërbime, rritja reale e parashikuar e ekonomisë për vitin 2002 është 7.0 për qind, duke qëndruar afërsisht në të njëjtin nivel edhe gjatë dy viteve të ardhshme.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm të ekonomisë, megjithëse do të vazhdojnë të karakterizohen nga deficite të ndjeshme të llogarise korente, nuk parashikohet të paraqesin probleme për pozicionin e jashtëm të Shqipërisë. Deficiti i llogarisë korente, gjatë vitit 2002, pritet të arrijë në 8.2 për qind të PBB-së, duke u thelluar disi kundrejt vitit 2001, kur ai vlerësohet të jetë 7.4 për qind.

Deficitet e llogarisë korente reflektojnë pozitën e dobët të sektorit prodhues të ekonomisë shqiptare për të përmbushur nevojën e tregut vendas dhe për të qenë konkurrencial në tregjet botërore. Në periudhën afatshkurtër, këto deficite janë mbuluar dhe pritet të vazhdojnë të mbuloohen në një masë të madhe nga dërgesat valutore të emigrantëve. Megjithatë, ngushtimi i pritur i deficitit të llogarisë korente në periudhën afatmesme do të kufizojë ekspozimin e ekonomisë shqiptare ndaj këtij problemi.

Politika fiskale e kujdesshme, e konkretizuar në buxhetin e miratuar në Kuvend, do të ketë një peshë të madhe në stabilitetin e ekonomisë. Deficiti buxhetor, i cili është parashikuar të arrijë në 8.5 për qind të PBB-së nga 9.0 për qind që ishte në vitin 2001, do të mbulohet në masën më të madhe nga financimi i huaj, i cili është parashikuar të arrijë në 4.2 për qind të PBB-së, dhe të ardhurat e privatizimit, të cilat janë parashikuar të përbëjnë 1.6 për qind të PBB-së. Huamarrja e qeverisë në tregun e brendshëm do të pësojë tkurrje në terma relativë kundrejt vitit 2001. Kështu, financimi i deficitit me burime të brendshme është parashikuar të jetë në nivelin 2.6 për qind të PBB-së kundrejt 3.1 për qind, që ishte në vitin 2001.

Zhvillimet monetare do të jenë në një linjë me zhvillimet e ekonomisë në përgjithësi. Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mbajë në fokusin e saj nivelin e çmimeve në ekonomi. Ajo do të ndjekë respektimin e kufijve të rritjes së agregatëve monetarë, në prani të një kursi të lirë këmbimi.

Programi monetar i hartuar nga ajo, parashikon një rritje të ofertës monetare në masën 11.4 për qind, duke u mbështetur në parashikimin e një shpejtësie të qëndrueshme të qarkullimit të parasë, e rritjes ekonomike 7 për qind dhe të objektivit të inflacionit 2 – 4 për qind.

Financimi i deficitit buxhetor nga sistemi bankar është parashikuar të jetë vetëm 2.2 për qind i PBB-së kundrejt 2.8 për qind në vitin 2001. Rritja e mjeteve monetare në ekonomi, në prani edhe të reduktimit të kërkesës së qeverisë, do të shërbejë për të rritur hapësirat për kreditimin e ekonomisë gjatë vitit 2002. Kredia për ekonominë, gjatë vitit 2002, është parashikuar të rritet me 8.8 miliardë lekë të tjera. Rritja e depozitave në valutë dhe arkëtimi i të ardhurave të privatizimit do të bëjnë që sistemi bankar të rrisë më tej mjetet e tij valutore. Rezerva valutore e Bankës së Shqipërisë është parashikuar të arrijë në kufirin e 800 milionë usd, duke mbuluar 4.7 muaj importi.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë është e ndërgjegjshme për rreziqet e pranishme në ekonominë shqiptare, të cilat vënë në dyshim parashikimin e rritjes ekonomike dhe përbëjnë pengesa edhe për arritjen e objektivit të çmimeve.